



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**NJOFTIM  
PËR REKRUTIMIN E NJË EKSPERTI TË JASHTËM PËR ASISTENCË DHE  
KONSULENCË LIGJORE PËR ANALIZË LIGJORE**

**TERMAT E REFERENCËS**

**Për rekrutimin e një eksperti të jashtëm për asistencë dhe konsulencë ligjore**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në funksion të përmbushjes së detyrave të tij ligjore dhe në zbatim të nenit 191 të ligjit organik nr. 54/2024, si dhe në kuadër të angazhimeve institucionale për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe plotësimin e kuadrit ligjor me aktet nënligjore përkatëse, vlerëson të nevojshme angazhimin e një eksperti të jashtëm për ofrimin e asistencës dhe konsulencës ligjore.

Ky angazhim synon mbështetjen e AKEP në hartimin e akteve nënligjore dhe në realizimin e analizave ligjore në lidhje me zhvillimet më të fundit të kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve digjitale.

**Objektivi i angazhimit**

Objektivi kryesor i këtij angazhimi është ofrimi i asistencës dhe ekspertizës ligjore për:

- hartimin e akteve nënligjore në kompetencë të AKEP;
- analizën e përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- identifikimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore për transpozimin e akteve të BE-së në legjislacionin kombëtar.

**Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit**

Eksperti do të ofrojë asistencë dhe konsulencë ligjore për realizimin e këtyre produkteve:

**1. Analiza ligjore e legjislacionit të BE-së**

- Hartimi i një dokumenti analize ligjore mbi detyrimet dhe impaktin e Rregullores (EU) 2024/1309 – Gigabit Infrastructure Act (GIA) në raport me kompetencat akutale të AKEP dhe legjislacionin ekzistues në fuqi, veçanërisht me ligjin nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”, duke përfshirë:
  - ✓ analizën e përputhshmërisë së legjislacionit ekzistues;
  - ✓ identifikimin e dispozitave ligjore që priten të ndryshohen ose shfuqizohen;
  - ✓ rekomandime për ndryshime ligjore dhe institucionale për transpozimin e rregullores

## 2. Hartimi i akteve nënligjore

- Hartimi i Rregullores për Cilësinë e Shërbimit (Quality of Service – QoS) në fushën e komunikimeve elektronike, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe acquis të BE-së.
- Hartimi i Rregullores për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare.

### Produktet e pritshme

Eksperti do të dorëzojë këto produkte, në rend kronologjik:

1. Dokument analize ligjore mbi impaktin e Rregullores (EU) 2024/1309 – Gigabit Infrastructure Act (GIA) në legjislacionin shqiptar, përfshirë rekomandime për ndryshime ligjore.
2. Draft Rregullore për Cilësinë e Shërbimit (QoS).
3. Draft Rregullore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.

Të gjitha dokumentet do të dorëzohen në formë elektronike dhe të shruar në gjuhën shqipe (dhe, nëse kërkohet, edhe në gjuhën angleze).

Angazhimi i ekspertit parashikohet të zgjasë **deri në 120 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

### Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Drejtësi (I detyrueshem nivel master).
- Përvojë profesionale/ekspertizë të paktën 10 vite në fushën e hartimit të legjislacionit parësor dhe sekondar.
- Njohuri të mira mbi acquis të BE-së në fushën e fushën e së drejtës publike, rregullimit të tregut ose legjislacionit të BE-së, shërbimeve digjitale dhe të komunikimeve elektronike
- Përvojë të ngjashme në hartim legjislacioni, akte nënligjore, analiza ligjore dhe harmonizim legjislacioni me BE-në, preferohet në sektorë të rregulluar
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze
- Marrëveshje/kontratë me ekspertë teknikë mbi bashkëpunimin për realizimin e shërbimit lidhur me draftrregulloret: “Për Cilësinë e Shërbimit (QoS) dhe “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

Eksperti duhet të prezantojë draftrregulloret: “Për Cilësinë e Shërbimit (QoS) dhe “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, në tryezat e diskutimit e diskutimit me grupet e interesit. që mund të organizohen nga AKEP në fazën e këshillimit publik, lidhur me

Pagesa do të kryhet në përputhje me kushtet e kontratës dhe pas dorëzimit dhe miratimit të produkteve përkatëse nga AKEP.

### Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Shprehja e interesit për aplikimin në thirrjen “Për rekrutimin e një eksperti të jashtëm për nevojat e AKEP”;
2. Diploma e shkollës së lartë në shkenca juridike;
3. Dokumentacioni që vërteton punë të ngjashme;
4. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës;
5. Propozim mbi afatet dhe kushtet financiare për realizimin e kërkesave të thirrjes
6. Jetëshkrimi;
7. Kopje ID/Pasaportë;

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Diploma e shkollës së lartë;	30 pikë
Përvojë profesionale/ekspertizë vërtetuar me dokumentacion përkatës;	40 pikë
Propozim mbi afatet dhe kushtet financiare;	20 pikë
Jetëshkrimi;	10 pikë

### **Përbën avantazh:**

- Kandidatët me përvojë pune mbi 10 vite në fushën e hartimit të legjislacionit parësor dhe sekondar dhe ekspertizës në sektorë të rregulluar.
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime në fushën e përafrimit të legjislacionit me atë të BE (të paraqiten referencat përkatëse);

**Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 10 Prill, në adresën Rr. Reshit Collaku, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AKEP.**

**KRYETARI**

**Gentian Sala**

